



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 719 Prot.

Tiranë, më 15.04.2026

V E N D I M

Nr. 91, Datë 15.04.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën me nr. 289, datë 26.11.2025, të znj. Th. A., kundër Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se: *Jam Th. A., dhe i përkas komunitetit rom. Problemi im ka filluar në vitin 2020 dhe vazhdon deri në ditën e sotme. Në vitin 2019 na u kërkua që, për të vazhduar aktivitetin e shitjes, të pajiseshim me NIPT si shitës ambulant. Më pas, për t’u regjistruar si punëkërkuës i papunë dhe për të përfitur sipas ligjit, na u tha se duhej ta mbyllnim NIPT-in, pasi ekzistenca e tij na penalizonte, edhe pse ai nuk ishte më funksional dhe ne nuk përfitonim të ardhura e ndihmës ekonomike. Kam shkuar shumë herë në QKB, por më sorollasin vazhdimisht dhe nuk ma mbyllin NIPT-in. Vazhdoj të figuroj si biznes, ndërkohë që nuk ushtroj asnjë aktivitet. NIPT-i është L92005455D.*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”, si dhe për marrjen e masave për çrregjistrimin e NIPT.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjisi.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1669/1 prot., datë 05.12.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në kuadër të hetimit administrativ të ankesës së paraqitur nga znj. Th. A., iu drejtua Qendra Kombëtare e Biznesit, duke kërkuar informacion të detajuar dhe dokumentacion zyrtar lidhur me të dhënat e regjistrimit, statusin juridik dhe çdo ndryshim eventual të subjektit të përfshirë në ankesë.
- Me shkresën nr. 2600/1 prot., datë 11.12.2025, e administruar pranë KMD me nr. 1670 prot., datë 16.12.2025, Qendra Kombëtare e Biznesit ktheu përgjigje zyrtare, duke informuar se:

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, datë 05.12.2025, protokolluar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Nr. 2600 prot., datë 09.12.2025, ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar, mbi bazën e NUIS/NIPT-it L92005455D, të vënë në dispozicion nga ana juaj, ju bëjmë me dije se NUIS/NIPT L92005455D nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar.

Referuar nenit 22 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, subjektet të cilët detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar janë: a) subjektet tregtare; b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil; c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur; ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja; d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit; dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë; e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së.

Ndërkohë, referuar shkresës tuaj, nga ana e znj. Th. A., pretendohet se është regjistruar si ambulant. Referuar Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ambulantët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve të cilët regjistrohen pranë organeve tatimore. Për sa më sipër, për marrjen e një informacioni më të detajuar, lutemi drejtohuni pranë organeve tatimore.

- Në vijim të procedurës hetimore, me shkresën nr. 1669/2 prot., datë 17.12.2025, KMD iu drejtua për kërkesë informacioni Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, duke kërkuar të dhëna dhe dokumentacion shtesë në funksion të sqarimit të plotë të rrethanave të çështjes.
- Për shkak të mungesës së përgjigjes brenda afatit të arsyeshëm administrativ, me shkresën nr. 53, datë 07.01.2026, Komisioneri iu drejtua sërish institucioneve të sipërcituara me rikujtesë zyrtare, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit ligjor për kthimin e përgjigjes.

- Me shkresën nr. 23147/1 prot., datë 06.01.2026, e administruar pranë KMD me nr. 74 prot., datë 09.01.2026, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë paraqiti përgjigje zyrtare, duke informuar lidhur me të dhënat që dispononte mbi subjektin dhe situatën përkatëse, si më poshtë:

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 1669/2 prot., datë 17.12.2025, protokolluar në DRT Tiranë me Nr. 23147 prot., datë 19.12.2025, me lëndë: “Njoftim dhe kërkesë për informacion lidhur me ankimin e tatimpaguesit Th. A., - ambulant me NIPT L92005455D”, ju informojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimet e sistemit informatik tatimor, tatimpaguesi Th. A., - ambulant me NIPT L92005455D rezulton me status “Pasiv” nga data 26.07.2022. Për të vazhduar procedurat e çregjistrimit, subjekti duhet të aplikojë për të ndryshuar statusin nga “Pasiv” në “Kërkesë për çregjistrim”.

Subjekti ka detyrime në kohë reale në vlerën 5,003 lekë, si dhe deklarata të padorëzuara, konkretisht listpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Korrik 2022.

- Me shkresën nr. 23147/3 prot., datë 14.01.2026, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë e administruar pranë Komisionerit me nr. 53/1 prot., datë 19.01.2026, ka konfirmuar se informacioni i kërkuar ishte dërguar në vijim të korrespondencës zyrtare me KMD.
- Me shkresën nr. 30/1 prot., datë 14.01.2026, e administruar pranë Komisionerit me nr. 159 prot., datë 15.01.2026, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqaroi se shkresën nr. 53, datë 07.01.2026 të Komisionerit e kishte përcjellë për kompetencë pranë Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si struktura përgjegjëse për trajtimin e çështjes.
- Me shkresën nr. 74/1 prot., datë 13.01.2026, Komisioneri i përcolli ankueses shkresën nr. 23147/1 prot., datë 06.01.2026 të Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për t'i dhënë mundësinë e paraqitjes së parashtrimeve dhe qëndrimit të saj lidhur me informacionin e administruar. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se ankuesja e ka marrë njoftimin, por nuk ka paraqitur asnjë përgjigje apo kundërshtim pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesat e ankuesëve, caktoi datën 25.02.2026, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 311 prot., datë 09.02.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua më datë 25.02.2026. Pala ankuese nuk mori pjesë, edhe pse ishte njoftuar për këtë seancë. Ndërkohë, pala kundër së cilës është paraqitur ankesa, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, mori pjesë në seancë dhe përfaqësoi qëndrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Gjatë seancës dëgjimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë mbajti të njëjtin qëndrim

³ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

siç ishte komunikuar më parë me shkrim, shpjegoi arsyet e qëndrimit të saj dhe iu la detyra të dërgonte informacion shtesë dhe një analizë të mëtejshme lidhur me rastin.

Duke marrë shkas nga mosdërgimi i informacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 25.02.2026, me shkresën nr. 608 prot., datë 25.03.2026, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si më poshtë:

Në vijim të procedurës administrative, si dhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 25.02.2026 pranë Komisionerit, gjatë së cilës u relatuan fakte dhe rrethana shtesë lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, u sqarua se:

- *NIPT L92005455D figuron me status “Pasiv” nga data 26.07.2022.*
- *Subjekti ka detyrime në kohë reale në vlerën 5,003 lekë, si dhe deklarata të paplota për periudhën Korrik 2022.*
- *Për të vazhduar procedurat e çregjistrimit, ankuesja duhet të aplikojë për ndryshimin e statusit nga “Pasiv” në “Kërkesë për çregjistrim”.*
- *Gjatë seancës dëgjimore u sqarua se në bazë të ndryshimeve ligjore të fundit, disa kategori subjektesh mund të përfitojnë falje të pjesshme ose totale të kamatave, gjobave dhe detyrimeve, përfshirë edhe raste si i ankueses.*

Në këto kushte, ju kërkojmë që të depozitoni pranë Komisionerit:

1. *Informacionin e detajuar mbi statusin e NIPT L92005455D dhe shumën e detyrimeve tatimore të ankueses.*
2. *Shpjegimin e mundësive për zbritje/falje të kamatave, gjobave dhe detyrimeve sipas ndryshimeve ligjore të fundit.*
3. *Procedurat që ankuesja duhet të ndjekë për të realizuar çregjistrimin e NIPT.*

Në kushtet kur nuk kemi marrë informacion të plotë dhe dokumentacionin përkatës sipas detyrave të lëna në seancën dëgjimore të datës, 25.02.2026, po ju rikërkojmë që të depozitoni pranë Komisionerit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, në zbatim të detyrimeve ligjore.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, si dhe në analizë të legjislacionit poshtëcituar, Komisioneri vlerëson se:

Në bazë të nenit 5 “Pëkufizime”, Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: j) “Ambulant” nënkupton një person

tatimpagues, i cili tregon mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, por ushtron aktivitet në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme, apo lejohet të tregtojë në ambiente publike të autorizuara nga strukturat e pushtetit vendor që administrojnë territorin dhe që për qëllime të pagesës së tatimeve dhe kontributeve regjistrohen si tatimpagues ambulant në administratën tatimore.

Neni 40 “Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”, Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare është parashikuar se: *Pika 4.1. Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: ç) të vetëpunësuarit në veprimtari, si shitës ambulant, sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “j”, të nenit 5, të këtij ligji.*

Neni 45 “Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve”, është parashikuar se:

1: Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë regjistruar në administratën tatimore, sipas pikave 1 deri 4, të nenit 40, dhe të nenit 42, të këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë. 2: Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë të regjistruar në administratën tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

3.3 Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të personave fizikë, apo paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit për personat juridikë, është e detyruar të verifikojë dhe të vlerësojë situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit në llogarinë e tij në kontabilitetin dhe sistemin e të dhënave që disponon. Për situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit, si dhe për deklaratat e padorëzuara nga ai, administrata tatimore njofton brenda këtyre 10 ditëve tatimpaguesin; situata e tatimpaguesit në kohë reale rezulton detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklaratat tatimore të padorëzuara, si dhe, në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes.

3.5 Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjektet, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (e-mail) ose dhe me shkresë zyrtare.

3.5 Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit/subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklaratat të padorëzuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar menjëherë në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

Në Vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me VKM nr. 211, datë 9.4.2025, përcaktohet detyrimi i dorëzimit elektronik të deklaratave tatimore dhe dokumenteve

të tjera tatimore, të cilat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet formës elektronike, duke filluar nga 1 janari 2015, sipas afateve ligjore dhe formës së miratuar me udhëzim të ministrit të Financave; deklaratat tatimore përfshijnë formularë të TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe personale, tatimit të mbajtur në burim, taksave kombëtare dhe tarifave, deklaratat për të punësuarit rishitësi ose të larguarit nga puna, deklaratat për lojërat e fatit, tatimin mbi rentën minerare dhe listëpagesat e kontributeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, ndërsa dokumentet tatimore përfshijnë librat e shitjes dhe blerjes për TVSH-në, pasqyrat financiare vjetore me shënimet shpjeguese dhe tabelat shoqëruese, si dhe vendimet për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit pas tatimit;etj.

Bazuar në Manualin e Shërbimeve për Tatimpaguesit dhe Individët, miratuar me Urdhër Nr. 81, datë 22.12.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, një shitës ambulant, në cilësinë e tatimpaguesit, ka një sërë detyrimesh që duhet t'i përmbushë ndaj Administratës Tatimore. Ai duhet të jetë i regjistruar rregullisht, të deklarojë dhe të paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas kategorisë që i përket, dhe të mbajë gjithnjë të rregullt situatën e tij tatimore. Nëse lind ndonjë paqartësi lidhur me përgjegjësitë tatimore apo kategorinë e sigurimeve, shitësi ambulant mund të dërgojë kërkesë nëpërmjet sistemit e-filing (i njohur ndryshe si “tatimet e mia”, është platforma elektronike e Administratës Tatimore nëpërmjet së cilës tatimpaguesit dhe qytetarët mund të kryejnë një sërë veprimesh tatimore pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht pranë sporteleve.), ku brenda një dite pune do të njoftohet për rregullimin përkatës.

Nga aktet e depozituara dhe pohimet e palëve në këtë proces, rezulton se:

Ankuesja, Th. A., nga komuniteti rom, ka pretenduar se problemi i saj ka filluar në vitin 2020 dhe vazhdon deri në ditën e sotme. Ajo deklaron se në vitin 2019 iu kërkua pajisja me NIPT si ambulante për të vazhduar aktivitetin e shitjes, ndërkohë që më pas, për të regjistruar statusin si punëkërkuese e papunë dhe për të përfituar sipas ligjit, iu është kërkuar mbyllja e NIPT-it, pasi ekzistenca e tij penalizonte të drejtën për përfitime sociale, edhe pse NIPT-i nuk ishte më funksional dhe nuk gjeneronte të ardhura. Sipas subjektit ankues, pavarësisht vizitave të shumta në Qendrën Kombëtare të Biznesit, NIPT-i nuk është mbyllur dhe ajo vazhdon të figurojë si subjekt ekonomik, duke mos ushtruar asnjë aktivitet. NIPT-i i ankuseses është L92005455D.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ankuesja kërkoi konstatimin e diskriminimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”, si dhe marrjen e masave për çrregjistrimin e NIPT.

Komisioneri, në bazë të kompetencës ligjore të përcaktuar në nenin 32, pika 1, gërma a, të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, (LMD), ndërmori procedurat e hetimit administrativ duke iu drejtuar me shkresë nr. 1669/1 prot., datë 05.12.2025, Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të marrë informacion të detajuar dhe dokumentacion zyrtar

lidhur me të dhënat e regjistrimit, statusin juridik dhe çdo ndryshim eventual të subjektit ankues Th. A., si dhe me shkresë nr. 1669/2 prot., datë 17.12.2025, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të marrë të dhëna shtesë mbi statusin tatimor të ankueses, detyrimet e papaguara, deklaratat e paplota dhe procedurat për çregjistrimin e NIPT, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes dhe shqyrtimin e pretendimeve të diskriminimit.

Nga verifikimi i kryer nga QKB, NIPT L92005455D nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar, ndërsa sipas Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ankuesja rezulton me status “Pasiv” që nga data 26.07.2022. Për të përfunduar çregjistrimin e NIPT, ajo duhet të aplikojë për ndryshimin e statusit nga “Pasiv” në “Kërkesë për çregjistrim”.

Gjithashtu, ankuesja ka detyrime në kohë reale në vlerën 5,003 lekë, si dhe deklarata të paplota për periudhën Korrik 2022. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka sqaruar gjithashtu mundësinë e përfitimit të faljeve të pjesshme ose totale të kamatave, gjobave dhe detyrimeve sipas ndryshimeve ligjore të fundit.

Komisioneri ka dërguar ankueses informacionin e kërkuar dhe i ka lënë mundësinë paraqitjes së qëndrimit të saj lidhur me dokumentacionin administrativ, por ajo nuk ka paraqitur asnjë përgjigje ose kundërshtim. Gjatë seancës dëgjimore të datës 25.02.2026, ankuesja nuk mori pjesë, ndërsa Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë mbajti qëndrim të njëjtë si ai i komunikuar me shkrim, duke sqaruar procedurat dhe duke premtuar informacion shtesë në vijim të korrespondencës.

Bazuar në sa më sipër, evidentohet se pengesa reale për çregjistrimin e NIPT nuk ka qenë refuzimi i autoriteteve për të përfunduar procedurat, por detyrimi i ankueses për të plotësuar disa kërkesa formale, përfshirë pagesat dhe aplikimin për ndryshimin e statusit në sistemin tatimor, si dhe për deklaratat e paplota të periudhës Korrik 2022. Ankuesja ka qenë e njoftuar për hapat që duhen ndjekur dhe për mundësitë e zbritjes/faljes së detyrimeve sipas ndryshimeve ligjore, por nuk ka ndërmarrë veprimet e kërkuara për të përfunduar çregjistrimin.

Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe faktet e administruara gjatë procesit, Komisioneri vlerëson se:

Lidhur me çregjistrimin e NIPT, neni 45, pika 2, i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se subjektet e regjistruara si ambulante çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat. E njëjta dispozitë, pika 3.3, detyron administratën tatimore që brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës për çregjistrim të verifikojë situatën tatimore të subjektit dhe të njoftojë tatimpaguesin për detyrimet e papaguara dhe deklaratat e padorëzuara.

Në rastin konkret, ankuesja Th. A., rezulton me status “Pasiv” që nga data 26.07.2022, ka detyrime tatimore në vlerën 5,003 lekë dhe deklarata të paplota për periudhën Korrik 2022. Kjo do të thotë

se, në zbatim të nenit 45, pika 3.5, çregjistrimi nuk mund të realizohet automatikisht, pasi kushti ligjor i mungesës së detyrimeve dhe deklaratave të padorëzuara nuk është plotësuar nga ana e ankueses.

Në këto kushte, pengesa për çregjistrim nuk buron nga një veprim apo mosveprim i autoriteteve tatimore, por nga mosplotësimi i kushteve formale ligjore nga vetë ankuesja, e cila duhet të aplikojë për ndryshimin e statusit nga “Pasiv” në “Kërkesë për çregjistrim”, të shlyejë detyrimet e papaguara dhe të dorëzojë deklaratat e mungura duke pasur mundësinë, sipas ndryshimeve ligjore të fundit, të përfitojë falje të pjesshme ose totale të kamatave dhe gjobave.

Rrjedhimisht, mosplotësimi i këtij detyrimi, i bashkuar me ekzistencën e detyrimeve tatimore të papaguara në vlerën 5,003 lekë, përbën pengesën ligjore konkrete që bllokton procedurën e çregjistrimit, pengesë e cila buron nga mosveprimi i vetë ankueses dhe jo nga ndonjë trajtim i pabarabartë apo diskriminues i ushtruar ndaj saj nga autoritetet tatimore.

Si përfundim, referuar dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve të kryera nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton se institucionet kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për çregjistrimin e NIPT L92005455D të ankueses Th. A., duke informuar për detyrimet e papaguara, deklaratat e paplota dhe procedurat për ndryshimin e statusit. Megjithatë, çregjistrimi nuk ka mundur të përfundojë për shkak të mosplotësimit të kushteve formale nga vetë ankuesja, përfshirë aplikimin për ndryshimin e statusit, shlyerjen e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe dorëzimin e deklaratave tatimore të papaguara.

Në këto kushte, për sa kohë legjislacioni në fuqi parashikon si kusht shlyerjen e detyrimeve tatimore të papaguara, dorëzimin e deklaratave tatimore të padorëzuara dhe aplikimin për ndryshimin e statusit nga “Pasiv” në “Kërkesë për çregjistrim”, qëndrimi dhe veprimet e institucioneve përkatëse, kanë qenë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave në fuqi, duke informuar ankuesen për detyrimet e papaguara dhe hapat që duhen ndjekur për çregjistrim. Pengesa reale për përfundimin e çregjistrimit të NIPT-së buron nga mosveprimi i ankueses për të përmbushur këto kushte ligjore dhe jo nga veprimet ose mosveprimet e administratës tatimore.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ardhur për shkak të pretenduar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. Th. A., për shkak të “*races*” dhe “*gjendjes ekonomike*”, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë .
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA